



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.02.2021, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “DEFENDER EUROPE 21”

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Elena Xhina Duka, Antoneta Dhima, Artemis Dralo Malo, Myslim Murrizi, Sadi Vorpsi, Arben Elezi, Luan Duzha, Edmond Stojku, Xhemal Qefalia dhe Nimet Musaj

Mungojnë:

Alban Zeneli, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Elona Hoxha Gjebrea, Luan Harusha, Lefter Maliqi, Edmond Rrushi dhe Ylli Shehu

Të ftuar:

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Ardit Çollaku – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes

Beqir Tafili – Drejtor i Drejtorisë se Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Alban Gjilani – Përgjegjës i Sektorit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita, kolegë!

Meqenëse kuorumi është i plotë, çelim mbledhjen e Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës të kësaj mbledhjeje kemi projektligjin “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate (domethënë NATO) në stërvitjen e përbashkët “DEFENDER EUROPE 21”.

Të ftuar për të prezantuar këtë projektligj kemi përfaqësuesit nga Ministria e Mbrojtjes: zotin Petro Koçi, zëvendësministër, faleminderit, zoti Koçi; zotin Ardit Çollaku, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes, zotin Beqir Tafili, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, si dhe zotin Alban Gjilani, përgjegjës i Sektorit të Akteve Rregullore po nga kjo ministri. Ndërkohë, relator i Komisionit të Sigurisë për këtë projektligj do të jetë kolegu Myslim Murrizi.

Ju uroj mirëseardhjen, zoti Koçi, në Komisionin e Sigurisë, ndërkohë tani ju jap fjalën për të prezantuar projektligjin.

Fjala është për ju, zoti Petro Koçi.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuara anëtare dhe anëtarë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare,

Për mua është kënaqësi dhe, natyrisht, krenari e veçantë që në këtë pjesë të sezonit kuvendor të prezantoj para jush projektligjin e qeverisë lidhur me zhvillimin e stërvitjes “DEFENDER EUROPE 21”. Kjo është një stërvitje e cila do të zhvillohet në periudhën 26 prill-20 qershor të këtij viti, meqenëse sipas përkufizimeve të Kushtetutës, nëse në një stërvitje marrin pjesë më shumë se 1000 ushtarakë të huaj, atëherë vendimi në këtë rast nëpërmjet një ligji i takon Kuvendit, ndërsa në rastet e tjera, sipas numrave të reduktuar, mund t’i takonte qeverisë apo edhe vetë ministrit të Mbrojtjes.

Kështu, meqenëse kësaj radhe kemi një pjesëmarrje masive, dhe besoj kjo është stërvitja më e madhe në pikëpamje të pjesëmarrjes në numrat e ushtarakëve të huaj, pra në gjithë këtë histori stërvitjesh ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë është më e madhja, atëherë kërkojmë patjetër lejen e Kuvendit, nëpërmjet ligjit, që të zhvillohet kjo stërvitje.

Do të jenë 3100 ushtarakë të huaj që do të marrin pjesë në këtë stërvitje. Janë kryesisht ushtarakë amerikanë, por do të ketë edhe të tjerë nga vendet anëtare të NATO-s, por edhe nga vendet partnere, siç janë Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Kanadaja, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Turqia, por edhe të tjerë.

Stërvitja do të zhvillohet në bazat tona ushtarake. Pra e gjithë kjo stërvitje do të zhvillohet në komandat forcave tokësore, ajrore dhe detare në garnizonin “Skënderbej”, në bazën ajrore të Farkës, në bazën ajrore të Kuçovës dhe në poligone stërvitore të Bizës dhe të Fekenit, si dhe do të lejohet rrugëkalimi për të shkuar apo edhe për t’u kthyer nga këto baza ushtarake që do të jenë ndërkohë dhe vendet e zhvillimit të stërvitjes.

Më lejoni të theksoj, gjithashtu, edhe disa detaje të tjera lidhur me mjetet ushtarake që të do të përdoren gjatë stërvitjes. Janë 12 helikopterë shumërolësh, dhe “Medevak”, 6 sisteme raketash “Patriot”, 1000 automjet të ndryshme transporti, 10 mjete detare, do të ketë avionë transporti edhe për personelin, edhe për mallrat. Ndërkohë, do të ketë 25 mjete fluturuese që do të marrin pjesë në misionin “Astro night”, pjesë e stërvitjes “Defender Europe 2021”, dhe do të jenë 10 avionë F15, 2 avionë F16, 2 avionë F35, njëri italian dhe tjetri amerikan, 3 avionë të tipit KC 135 për furnizimet në ajër, 7 helikopterë për kërkim-shpëtim dhe një avion patrullimi C130.

Pra, bëhet fjalë për një stërvitje komplekse, e cila do të zhvillohet, gjithashtu, në një terren kompleks stërvitor. Qëllimi është që trupat tona ushtarake të aftësohen më tej, për të pritur dhe koordinuar me forca ushtarake partnere, në stërvitje dhe operacione të përbashkëta, të cilat natyrisht do ta rrisin, efektivitetin e përdorimit të kapaciteteve tona ushtarake, në të gjitha sfidat e mëvonshme që mund të jenë nga më të ndryshmet, përballë jo vetëm Forcave tona të Armatosura, por edhe të gjitha vendeve tona aleate, në misione të ndryshme, në të cilat merr pjesë, natyrisht me dinjitet të plotë edhe Shqipëria.

Sipas ligjit dhe siç e shikoni në përmbajtjen përkatëse, në këtë rast ngarkohet përveç Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme dhe natyrisht ministrat përkatës, po dhe Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë për zbatimin e këtij ligji.

Gjithashtu, dua të theksoj se në çdo rast, prezenca e ushtarakëve të huaj, do të shoqërohet nga Forcat tona të Armatosura, pra nga ushtarakët tanë të njëjësive tona të ndryshme, përfshirë edhe Policinë Ushtarake, që do të shoqërojë gjithmonë prezencën e këtyre ushtarakëve të huaj.

Me këtë rast dua të falenderoj komandën e ushtrisë amerikane në Europë, e cila do ta drejtojë këtë stërvitje të madhe! Natyrisht, ne jemi mirënjohës që u zgjodh Shqipëria, për të

dëshmuar edhe një herë që Shqipëria është një aleate dinjitoze jo vetëm e NATO-s, por edhe një partnere e ngushtë strategjike për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Unë besoj se komisioni do ta kalojë me konsensus këtë projektligj dhe do ta prezantojë në seancën plenare më të afërt.

Faleminderit shumë për vëmendjen!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi për fjalën tuaj dhe prezantimin që bëtë për projektligjin e ardhur në Kuvend.

Tre anëtarë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, zoti Murrizi, zoti Qefalia dhe zotën Musaj, janë njëkohësisht edhe anëtarë të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, ndaj besoj se fokusi i projektit, e lidhur ngushtë edhe me këtë gjë, na bën në komision përgjegjës.

Fjalën e ka zoti Murrizi për të relatuar projektligjin.

Faleminderit!

Fjala është për ju, zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë, pas parashtrimit që zëvendësministri i Mbrojtjes, zoti Koçi, i bëri projektligjit unë nuk po hyj në detaje, sepse po t'i përmend edhe unë ata qytetarët shqiptarë do të mendojnë që këtu do të bëhet nami. Kam hall se mos këto mjete, tanket, blindat, do t'ju kujtojnë ndonjë ngjarje të keqe, që unë dhe zoti Koçi e kemi jetuar.

Si anëtar i Komisionit të Sigurisë, por edhe i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, që në fillim dua të shpreh dakordësinë time për miratimin e këtij projektligji që në këndvështrimin tim është më shumë dhënie lejeje për ardhjen e më shumë sesa një mijë trupave, që i përket ministres dhe të dymijë trupave, që i përket qeverisë. Pra, meqë bëhet fjalë për 3100 trupa, kërkohet një miratim nga Kuvendi i Shqipërisë.

Ajo që do të shtoj, përveç parashtrimit që bëri zoti Koçi, është se Forcat Ushtarake të Republikës së Shqipërisë do të marrin pjesë në këtë stërvitje me 960 efektivë, përfshirë të gjitha forcat që zoti Koçi përmendi. Stërvitja do të zhvillohet në një periudhë 1 mujore, nga data 13-maj-10 qershor, e ndarë në periudha të ndryshme: 17-2 qershor njëra pjesë, 16 maj-10 qershor pjesa tjetër dhe 13-maj 21 maj pjesa e tretë.

Vendimi për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në stërvitje të përbashkëta ushtarake ndërkombëtare, në veprimtari të organizuara, të autorizuara ose të drejtuara nga NATO-ja, Bashkimi Evropian apo vendet e tjera në territor kur e kalon këtë numër, kërkon një autorizim nga Kuvendi.

Si deputet i opozitës dhe anëtar i këtij komisioni shpreh dakordësinë time dhe besoj se të gjithë kolegët e komisionit janë dakord që kjo të kalojë me konsensus, ashtu sikurse edhe ju e parashtruat.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Besoj se është e qartë edhe nga fjala e zëvendësministrit dhe e kolegut tonë, zotit Murrizi që pjesëmarrja e FA-së në këtë stërvitje të përbashkët të forcave të NATO-s dhe vendeve anëtare, si dhe leja që i kërkohet Kuvendit të Shqipërisë që nëpërmjet vendimmarrjes së tij të lejojë kalimin e 3100 trupave në territorin shqiptar, kanë një synim me të cilin besoj se biem të gjithë dakord, pra, që Forcat e Armatosura të rrisin aftësitë e tyre sa teknike aq dhe operacionale në një stërvitje që duket komplekse, ku marrin pjesë të gjitha vendet e NATO-s dhe vende të tjera partnere dhe që në këtë rast ka gjetur si territor të zhvillimit të saj vendin tonë në një periudhë jo të vogël, sepse sipas asaj që përshkruhet në nenin 4 të projektligjit kjo stërvitje do të zhvillohet në periudhën 26 prill-20 qershor me ato ndarje që përmendi kolegu Murrizi.

Sidoqoftë diskutimi për pyetje është i hapur për kolegët, ndaj nëse keni pyetje ne kemi këtu përfaqësi të nderuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe mund të ezaurohen të gjitha pyetjet në lidhje me këtë stërvitje.

Zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Zonja kryetare, unë nuk kisha pyetje. Edhe unë jam shumë krenar si zoti Murrizi, por kisha një falënderim të veçantë për ju si kryetare për faktin që keni bërë një kolegun tim shumë të nderuar, zotin Murrizi, anëtar i delegacionit të NATO-s. Pavarësisht se në Rregulloren e Kuvendit përcaktohet që nisma të tilla vijnë nga qeveria dhe nga maxhoranca, por kur vjen puna për çështjet e sigurisë kombëtare, sidomos në rastin konkret, na bën krenar të gjithëve.

Uroj që të përfaqësohemi denjësisht në këtë aktivitet kaq të rëndësishëm!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

A ka pyetje nga kolegët?

Zoti Koçi, besoj se jemi të gjithë të qartë për termat e ligjit dhe të marrëveshjes për të cilën është rënë dakord nga ana juaj dhe ekomandës së NATO-s në Europë, kështu që do të propozoja të kalonim në miratimin e projektligjit.

Kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut

dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “DEFENDER EUROPE 21”? Kundër dhe abstenime nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1 të këtij projektligji? Kundër dhe abstenime nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Neni 2 i projektligjit bën fjalë për lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 3100 trupave aleate, që do të marrin pjesë në stërvitje.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër dhe abstenime nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 3 të projektit në të cilin sanksionohet qëllimi i pjesëmarrjes së Forcave tona të Armatosura në paketën e stërvitjes “DEFENDER EUROPE 21”.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Neni 4 bën fjalë për kohën e zhvillimit të kësaj stërvitjeje dhe vendet ku do përqendrohet ajo. Në fakt, e përmendi edhe zëvendësministri se ku do përqendrohet kjo stërvitje, pra ku do të jenë komandat tona të forcave të tokësore, ajrore dhe detare, garnizoni “Skënderbej”, baza ajrore e Farkës dhe ajo e Kuçovës dhe poligoni stërvitor i Bizës dhe Fekenit, si dhe të gjitha rrugëkalimet ajrore dhe tokësore në këtë rajon.

A ka pyetje dhe diskutime për nenin 4? Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 specifikon numrin e trupave dhe të mjeteve, pra të gjithë infrastrukturës ushtarake që duhet të dislokohet në vendin tonë në rastin e kësaj stërvitjeje.

Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 parashikon statusin që do të gëzojnë trupat e vendeve aleate gjatë kohës së qëndrimit të tyre në territorin Republikës së Shqipërisë.

Kush është dakord me nenin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 sanksionon detyrimin që duhet të kenë njësitë e armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për të shoqëruar trupat e vendeve aleate gjatë kohës së qëndrimit të tyre në territorin tonë.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 sanksionon detyrimin që kanë ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm dhe ai Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij ligji. Pra, për të bërë të mundur gjithçka që është parashikuar në këtë ligj.

Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9 bën fjalë për hyrjen në fuqi të ligjit, që do të jetë në afatin e zakonshëm që parashikon Kushtetuta.

Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord me votimin në tërësi të projektligjit të mësipërm? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet unanimitisht ky projektligj.

Zoti Koçi, faleminderit! U urojmë Forcave të Armatosura, në emër të Komisionit të Sigurisë, stërvitje sa më të mbarë!

Petro Koçi – Natyrisht, ju falënderoj ju dhe të gjithë anëtarët e komisionit për konsensusin e dhënë për projektligjin. Dua të përshëndes në mënyrë të veçantë pjesëmarrjen e ushtarakëve të Kosovës në këtë stërvitje shumëkombëshe që zhvillohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Faleminderit të gjithë kolegëve të Komisionit të Sigurisë!

Dëgjohemi në mbledhjen e radhës, të cilën e kemi në ditën e martë të javës që vjen.

Ditën e mirë!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA